

Deri te:

## Këshilli Mësimor - Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës

**Lënda:** Vlerësimi i disertacionit të doktoraturës së kandidates Diellza Kelmendi me temë:

“Dallimet në treguesit kinematik ndërmjet gjuajtjeve me kërcim dhe pa kërcim nga pozita të ndryshme në lojën e basketballit”

Me vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës, nr.19-396/1, nga mbledhja e mbajtur më 01.07.2019, për formimin e Komisionit për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës me titull “Dallimet në treguesit kinematik ndërmjet gjuajtjeve me kërcim dhe pa kërcim nga pozita të ndryshme në lojën e basketballit” të kandidatës Mr. Diellza Kelmendi, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Fadil Rexhepi, mentor; Prof. Dr. Hyjnor Kica, anëtar; Prof. Dr. Fadil Nika, anëtar; Metin Dalip, anëtar; Haki Ismaili, anëtar; Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike i paraqet këtë:

### RAPORT

#### për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Mr. sc. Diellza Kelmendi ka lindur në Prishtinë në vitin 19.09.1983. Shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Prishtinë. Në vitin 2007 mbaroi studimet Bachelor në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2014 mbaroi magjistraturën në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Kolegjin AAB në Prishtinë dhe mori titullin ‘Magjistër i Shkencave Sportive’.

Përvoja profesionale:

Nga viti 2012 deri më 01.10.2018 është angazhuar si asistente e rregullt në Fakultetin e Kulturës Fizike në “Kolegji AAB” në lëndën e Basketballit dhe lëndën e Hendballit. Nga 01.10.2018 është angazhuar si asistente në lëndën e Biomekanikës në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës.

Nga viti 2000 – 2007, ka qenë basketballiste në “KB Universiteti” i Prishtinës si dhe e përfaqësueses së Kosovës.

Nga viti 2017 është angazhuar si Nënkryetare në Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës.

Nga viti 2017 është angazhuar si Kryetare e Këshillit Profesional në Federatën e Hendbollit të Kosovës.

Bashkëpunëtore profesionale në botimin: "Taktika në Basketboll" nga Dr. Sc. Hazir Salihu, 2017.

Mentore dhe anëtare e komisionit në 13 Punime Diplome bachelor në programin e Kulturës Fizike dhe Sportit në “Kolegji AAB”.

Deri më tani, Mr. sc. Diellza Kelmendi ka botuar këto punime shkencore:

1. Pireva, F., Vehapi, SH., Mikić, B., Pireva, A., Gashi, E., Kelmendi, D. Differences in motoric and anthropometric space between 12-year old boy basketball players and students. Sport Science, International Scientific Journal of Kinesiology, Vol. 8 (2015), Issue 2, 25-29, Travnik. ISSN 1840-3670. [www.sportscience.ba/pdf/br16.pdf](http://www.sportscience.ba/pdf/br16.pdf) ose [www.sportscience.ba](http://www.sportscience.ba) i [www.eft.ba](http://www.eft.ba)

2. Kelmendi, D., Myrtaj, N., Georgiev, G. (2016). Relations between basic motoric abilities with young handball players tested through ball handling test. Acta Kinesiologica, Vol.10, Issue 2, 82-84. December 25, 2016. e-ISSN: 1840-3700 p- ISSN: 1840-2976 <https://www.actakin.com/TEXT/TxAr1002.html>

3. Kelmendi, D., Myrtaj, N., Shaqiri, K., Risteski, B. (2017). The impact of basketball on anthropometric features and motor skills to the age groups from 12-13 years. 2nd International, Sport, Science, Education and Development Conference 2016., In SSED 2016, Zbornik radova, GOD. 2, BR. 2 (2017), Travnik. ISSN 2490-323X <http://inssed.com/2016/zbornik2017.pdf>

4. Shaqiri, D., Pireva, F., Vehapi, Sh., Myrtaj, N., Pireva, A., Gashi, B. (2017). Differences between basketball players and 15-year-old students in some anthropometric features and motor skills. Sport Science, International Scientific Journal of Kinesiology, Vol. 9, Issue 2. December. Travnik

ISSN 1840-3662 Web ISSN 1840-3670 UDK 796

5. Kelmendi, D., Ismaili, H., Myrtaj, N., Shaqiri, K., Turjaka, A., Saiti, B. (2017). Physical Activity and Health. International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health, / Vol. 4.7-8/ pp. 1-95/ TETOVA/ 2017.

ISSN 1857-931 (Print)

6. Kelmendi, D., Selim, M., Miftari, F. (2018). The Impakt of Kineziological Treatment of Plyometric Type in the Development of Motor and Specific Motor Skills in Handball. Journal of Education, Health and Sport. 2018;8(8):502-515. eISSN 2391-8306. DOI <http://dx.doi.org/10.5281/zenodo.1318906> <http://ojs.ukw.edu.pl/index.php/johs/article/view/5681>  
<https://pbn.nauka.gov.pl/sedno-webapp/works/871725>

7. Kelmendi, D., Myrtaj, N., Shaqiri, K. (2018). MEASURE CHARACTERISTICS OF PRECISION TESTS WITH TOP BASKETBALL PLAYERS FROM KOSOVO. International Scientific Jurnal of Kinesiology.

Vol. 11, Issue 1; June 28. 2018 COBISS .BH. Publisher /Copyright ©/: Physical Education Pedagogues Association-Ljubuški, Bosnia & Herzegovina Co-publisher /Copyright ©/: Association Echoes, Kaštel Sućurac, Croatia Print ISSN 1840-3662, Web ISSN 1840-3670 UDK 796, Catalogued in: COBISS BH

Në vitin 2015 regjistroi studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin e Kulturës Fizike - drejtimi kineziologji, Në vitin 2018 pasi ka dhënë të gjitha provimet, ka përgatitur projektin e temës së disertacionit të doktoraturës me temën "**Dallimet në treguesit kinematik ndërmjet gjuajtjeve me kërcim dhe pa kërcim nga pozita të ndryshme në lojën e basketbollit**", me mentor, Prof. Dr. Fadil Rexhepi.

Punimi i doktoraturës është i shtypur në 123 (njëqind e njëzet e tri ) faqe. Teksti është i ndarë në: 6 (gjashtë) kapituj, 24 nën kapituj, përmban 16 tabela, 12 grafikone dhe 150 njësi bibliografike.

Në këtë studim janë trajtuar parametrat kinematik si përcaktuesë kryesor të finalizimit të gjuajtjes në kosh në sportin e basketbollit. Ndryshimet e lojës së basketbollit në dekadat e fundit, kryesisht janë si rezultat i rësive shkencore të stërvitjes, por vlerë të rëndësishme poashtu ka zbatimi i parimeve biomekanike sidomos gjatë gjuajtjeve.

Kërkesat e performancës në sportet e ditës së sotme rriten vazhdimisht, me këtë edhe variantet e elementeve teknike. Saktësia e gjuajtjeve varet nga karakteristikat kinematike, shkalla e përgatitjes teknike dhe cilësia ritmike, pavarësisht nga distanca dhe pozicioni i unazës se koshit. Në vendin tonë në masë të madhe janë zhvilluar studime mbi aftësitë motorike, aftësitë funksionale, si dhe raportet dhe ndikimet ndërmjet tyre. Ka edhe fusha të tjera të interesimit të studiuesve të lojës së basketbollit të cilat kanë qenë dhe janë objekt i trajtimit. Por përshkrimi, përcaktimi dhe shpjegimi i karakteristikave lëvizore nga aspekti biomekanik është i një rëndësie të veçantë. Zbatimi i parimeve dhe ligjshmërive mekanike në lëvizjet e trupit të njeriut jep pasqyrë të saktë për gjendjen dhe mundësitë e përmirësimit të nivelit të teknikës në sportin e basketbollit dhe në sportet e tjera. Hulumtimet e derisotshme të cilat lidhen me lojën e basketbollit janë të shumta, por ato në të cilat janë aplikuar ecuritë e analizës kinematike janë në numër më të vogël. Analiza kinematike e gjuajtjeve jep pasqyrë të qartë për lëvizjen e pjesëve kryesore të trupit të basketballistit gjatë gjuajtjes së topit dhe të vetë lëvizjes së topit në kushte të caktuara. Evaluimi i treguesëve kryesor kinematik te basketballistët cilësor jep informata të sakta për nivelin e performimit dhe mundësitë e përmirësimit të teknikës. Ajo që këtë hulumtim e bën atë të ndryshëm nga hulumtimet tjera është analiza e njëkohshme e parametrave kinematik për realizimin e tri gjuajtjeve nga këto tre distanca të cilat janë më të aplikushme në lojën e basketbollit si dhe faza e lëshimit të topit nga këto tri gjuajtje.

Në pjesën e parë të punimit kandidatja ka shpjeguar fushën në të cilën e ka realizuar studimin, qëllimin e studimit, hipotezat e studimit si dhe rëndësinë teorike të këtij studimi.

Në **Hyrje** - Autorja nxjerr në pah se loja e bukur e basketbollit është një nga sportet ekipore i cili gjëzon një popullaritet mjafë të lartë në mbarë botën FIBA, (2008). Gjuajtja është pjesa më e rëndësishme e lojës me të cilën finalizohet i tërë aktiviteti që i paraprin gjuajtjes. Mënyrat me të cilat arrihet deri te shënimi në lojën e basketbollit është me veprime të shumta teknike. Poashtu në këtë kapitull potencohet se saktësia e gjuajtjeve në basketboll, përcaktohet nga parametrat biomekanik gjatë performimit.

Në **Qëllimin e hulumtimit** është paraqitur qëllimi themelor i këtij studimi i cili është analiza kinematike e gjuajtjes së topit në kosh nga këto tri pozita, që përdoren më shpesh në lojën e basketbollit, të realizuara nga basketballistë të nivelit elitar: gjuajtja e lirë, gjuajtja për dy pikë me kërcim, gjuajtje për tri pikë me kërcim, si dhe trajektorja e topit. Evaluimi i treguesve kryesor

kinematik te basketballistët cilësor jep informata të sakta për nivelin teknikë dhe mundësitet e përmirësimit të teknikës.

Në **Hipotezat themelore**, janë shtruar pikat kryesore të bazuara mbi qëllimet dhe problematikën e hulumtimit, edhe atë për fazën e parë (faza e përgatitjes për gjuajtje) dhe fazën e dytë (gjuajtja e topit).

**Rëndësia teorike e studimit**, është e lartë meqenëse ekzistojnë shumë pak hulumtime mbi këtë problematikë në këto hapësira, veçanërishtë në vendin tonë, ky studim merr një dimension të rëndësishëm, sepse plotëson një zbrazëtirë të madhe të njohurive mbi procesin stërvitor dhe zhvillimin e vetë garës në lojën e basketballit. Ajo që këtë hulumtim e bën të ndryshëm nga hulumtimet e tjera, është analiza e njëkohshme e parametrave kinematik trupor për realizimin e tri gjuajtjeve nga tri distanca, të cilat janë më të aplikueshme në lojën e basketballit, si dhe faza e lëshimit të topit nga këto tri lloje të gjuajtjeve. Duke u bazuar në rezultatet e studimit hapet një mundësi e re për studime të tjera të kësaj natyre me qëllim të thellimit të njohurive shkencore të problematikës së trajtuar.

**Kapitulli i parë** – Në këtë kapitull autorja i ka strukturuar, gjetjet e studiuesve të ndryshëm për çështjet të cilat trajtohen në këtë studim, ku ka theksuar më shumë hulumtimet e deritanishme që janë të lidhura ngushtë me lëndën e këtij hulumtimi, me theks të veçantë, të analizës kinematike të gjuajtjes së topit në kosh nga pozita të ndryshme .

**Në kapitullin e dytë** - Në këtë kapitull autorja ka përshkruara metodat dhe procedurat që janë përdorur për të mbledhur të dhënrat relevante, për studimin e analizës kinematike të gjuajtjes së lirë, gjuajtjes për dy pikë me kërcim, gjuajtjes për tri pikë me kërcim dhe trajektores së topit nga njëzet basketballistë elitarë të Kosovës. Mostra e entiteteve përbëhet nga 20 basketballistë profesionistë të Super Ligës së Kosovës (basketballistë nga K. B. Prishtina, K.B Kerasani, dhe K.B.Lipjani). Matjet dhe xhirimi i gjuajtjeve u realizuan gjatë sezonit stërvitor të vitit 2018. Në këtë hulumtim për fazën e përgatitjes për gjuajtje janë marrë gjithsej 19 variabla, ndërkaq për fazën e gjuajtjes së topit janë 10 variabla .

**Mbledhja e të dhënave** - Xhirimi i performimit të teknikave të gjuajtjeve në kosh është bërë me tri kamera të vendosura në kënde optimale, të cilat mund të reprodukojnë 60 foto për sekondë. Matjet dhe xhirimet e këtij studimi janë realizuar në sallën e sportit, vend ku edhe janë

zhvilluar stërvitjet e basketballistëve nëpër klubet e tyre. Në fillim është bërë xhirimi i kuadrit (frame) kalibrues në vendin ku janë performuar teknikat. Përmasat e kuadrit janë: 200 cm x 200 cm x 200 cm. Rradhitja e kamerave ka qenë e atillë, në mënyrë që, të gjitha pikat referuese të trupit të sportistëve të janë nën okularin e kamerave dhe të janë të dukshme. Të gjitha fazat e mëtutjeshme do të bëhen sipas ecurisë së Sistemit për Analizë Kinematike (APAS), duke nxjerrë rezultatet dhe vlerat e nevojshme të treguesëve kinematikë.

### **Metodat e përpërpunimit të rezultateve**

Të dhënat e mbledhura janë përpunuar nga softueri statistikor IBM SPSS Statistics 20 dhe janë përcaktuar parametrat statistikor me ndihmën e metodave: mesatarja aritmetike, devijimi standard, rezultati minimal, rezultati maksimal, skewness dhe kurtosis, koeficienti i korelacionit të Pearsonit midis variablate të aplikuara. Për vërtetimin e dallimeve ndërmjet meseve aritmetike të tri grupeve, është aplikuar LSD-testi. Për vërtetimin e dallimeve ndërmjet tre e më tepër grupeve, është aplikuar analiza e variancës (ANOVA) dhe; Për vërtetimin e dallimeve ndërmjet tre e më tepër grupeve në të gjithë hapësirën e analizuar të variablate është aplikuar analiza multivariante e variancës (MANOVA).

**Në kapitullin e tretë** – Në këtë kapitull atutorja ka paraqitur gjetjet e hulumtimit. Rezultatet janë të paraqitura në trajtën e të dhënavë statistikore dhe të përshkrimeve adekuate për analizën kinematike në fazën e përgatitjes për: gjuajtje të lira, gjuajtjeve për dy pikë me kërcim, gjuajtjeve për tri pikë me kërcim dhe faza e fluturimit të topit, nga njëzet basketballistë elitarë të Superligës së Kosovës.

Gjithësej janë 6 tabela të rezultateve të parametrave themelorë stastistikor të treguesëve kinematikë të trupit të basketballistëve elitarë në fazën e përgatitjes për gjuajtje dhe fazën e lëshimi të topit të gjuajtjes së lirë, gjuajtjes për dy pikë me kërcim, gjuajtjes për tre pikë me kërcim. Gjithësej janë 6 tabela të rezultateve të koeficientëve të korelacionit të Pearsonit të treguesëve kinematikë të trupit, të basketballistëve elitarë, për fazën e përgatitjes së gjuajtjes dhe fazën e lëshimi të gjuajtjes së lirë, gjuajtjes për dy pikë me kërcim, gjuajtjes për tre pikë me kërcim. Gjithësej janë 4 tabela të rezulatetve të dallimeve të basketballistëve elitarë në treguesit kinematikë të trupit, për fazën e përgaditjes për gjuajtje dhe fazën e lëshimit të topit në gjuajtjen

e lirë, gjuajtjën për dy pikë me kërcim dhe gjuajtjen për tre pikë me kërcim. Te rezultatet e dallimeve janë 4 tabela të paraqitura.

Gjithësej janë 12 grafikone ku janë të paraqitura nga sistemi i analizës kinematike, për lojtarin më të mirë të këtij studimi për dy fazat e gjuajtjës së lirë, gjuajtjës për dy pikë me kërcim dhe gjuajtjës për tri pikë me kërcim.

**Kapitulli i katërt:** Në këtë kapitull atutorja ka paraqitur diskutimin e gjetjeve. Rezultatet e analizës së të dhënave janë krahasuar me rezultatet e përsituara nga studiuesit e tjerë dhe janë të diskutuara në kontekstin e vërtetimit të hipotezave.

**Përfundimi** – në këtë pjesë të punimit gjetjet tregojnë se në fazën e përgatitjes përgjithës së gjuajtje në këndet e parametrave kinematikë trupor në: gjuajtjen e lirë, gjuajtjen për dy pikë me kërcim dhe gjuajtjen për tri pikë me kërcim, në finalzimin e suksesshëm në kosh janë fituar dallime domethënëse statistikore në variablat: këndi në gju (ana e djathë), këndi në gju (ana e majtë) fillimi, këndi në kofshë (ana e majtë) përfundimi, këndi në krah (ana e djathë) fillimi, këndi në kyçin e bërryli (ana e djathë) përfundimi, koha e lirimit të topit dhe qendra e rëndesës në fazën përfundimtare.

Për fazën e lëshimit të topit gjetjet e këtij studimi tregojnë se janë fituar dallime domethënëse statistikore në variablat: distanca ndërmejt qendrës së rëndesës dhe topit në pozitën fillestare, distanca ndërmjet qendrës së rëndesës dhe topit në pozitën përfundimtare, trajektorja e lëvizjes së topit (zhvendosja horizontale), trajektorja e lëvizjes së topit (zhvendosja vertikale), këndi i lëshimit të topit, shpejtësia fillestare e lëshimit të topit, koha e fluturimit te topit dhe koha totale. Kombinimi i parametrave trupor kinematik del të jetë thelbësor në finalizimin e gjuajtjeve të suksesshme në kosh, për gjuajtjet të lira, gjuajtjet për dy pikë me kërcim dhe gjuajtjet për tri pikë me kërcim. Rezultatet e këtij hulumtimi pasurojnë hapësirën e njohurive shkencore të analizës kinematike të këtyre tri gjuajtjeve për lojën e basketbollit, si dhe për fazën e lirimit të topit.

**Literatura** - Të gjitha referencat janë të përdorura nga Manueli i Publikimeve i shqatës së psikologëve amerikan (American Psychological Association - APA). Në këtë studim janë dhënë gjithësej 150 burime në lidhje me problematikën e studimit. Referencat janë nga autorë të vendit dhe të huaj.

## MENDIM DHE PROPOZIM NGA KOMISIONI

Punimi i disertacionit të doktoraturës me temë “**Dallimet në treguesit kinematik ndërmjet gjuajtjeve me kërcim dhe pa kërcim nga pozita të ndryshme në lojën e basketbollit**” i kandidatit Mr. Sc. Diellza Kelmendi, paraqet studim të rëndësishëm në fushën e hulumtimeve shkencore të Analizës Kinematike të gjuajtjeve në Basketboll.

Rezultatet e fituara të këtij hulumtimi pasurojnë hapësirën e njohurive shkencore të analizës kinematike të lojës së basketbollit. Hulumtime të tillë dhe të ngjashme e kanë vendosur sportin në një aktivitet me rëndësi të lartë të jetës shoqërore. Po ashtu kontributi shkencor i këtij hulumtimi jep njohuri të reja mbi modelin optimal të performancës së basketballistit gjatë gjuajtjes në kosh. Meqenëse ekzistojnë shumë pak hulumtime mbi këtë problematikë në këto hapësira, e sidomos ne vendin tonë ky studim merr një dimension të rëndësishëm sepse plotëson një zbrazëtirë të madhe të njohurive mbi procesin stërvitor dhe zhvillimin e vetë garës në lojën e basketbollit.

Nga përshkrimi si më lart, Komisioni i vlerësimit të punimit të disertacionit të doktoraturës me titull ”Dallimet në treguesit kinematik ndërmjet gjuajtjeve me kërcim dhe pa kërcim nga pozita të ndryshme në lojën e basketbollit” të kandidatit Mr. sc. Diellza Kelmendi, përfundon se punimi i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve që të aprovojë këtë raport të vlerësimit të punimit të disertacionit të doktoraturës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. - Fadil Nika anëtar 
2. Prof. Dr. Metin Dalip – anëtar 
3. Prof. Dr. Fadil Rexhepi – mentor 
4. Prof. Dr. Haki Ismaili – anëtar 
5. Prof. Dr. Prof Hyjnор Kica – anëtar 